



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I UR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
ISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

| | | | |
|--|-------------------------------|-------------------------------|-------------------------------|
| Pranuar / Dorezuar Prilijeno/Prodato Received/Delivery | 21.05.2021 | 1 | viti god. year. |
| Organ./Njësia Organ./Jedinica Org./Unit | Nr Prot Br Prot Prot No | Shtojca Prilog Appendix | Sasia Kolicina Quantity |
| KPM SHCK | 2575/2021 | | 1/1 |



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.613/2019

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje: Ardita Haxhnikaj Demi- kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Rushit Kajtazi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, sipas Aktgjykimit A.nr.3082/2019 të datës 16.04.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.613/2019 të datës 08.10.2019 të parashtruar nga ankuesi kundër organit të punësimit Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenin 47 dhe nenin 48 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 21.05.2021, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon Procedimi Administrativ i iniciuar me ankesën me numër A.nr.613/2019 të datës 08.10.2019 të parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, me datë 08.10.2019 ka parashtruar ankesë me numër protokoli 1962/2019 e regjistruar me A.nr. 613/2019, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, kundër organit të punësimit Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, me pretendimin ankimor që organi i punësimit lidhur me procedurën e rekrutimit për pozitën "Udhëheqës i Autoritetit Rajonal të Pellgjeve Lumore" sipas konkursit të datës 31.05.2019, ka vepruar në kundërshtim me nenin 80 paragrafi 3 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil, pasi që i njëjti me datë 31.05.2019 ka parashtruar ankesë në KPM SHCK lidhur me pozitën e njëjtë sipas konkursit paraprak.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 10.10.2019 përmes shkresës me numër protokoli 4711/2019 ka proceduar kërkesën për përgjigjen në ankesën e ankuesit të

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Ndërsa më datë 15.10.2019 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri më datë 08.10.2020, ka qenë jo funksional për shkak të mungesës së kuorumit, me ç'arsye Këshilli me datë 18.11.2019 përmes shkresës me numër protokolli 5409/2019 ka njoftuar ankuesin për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës së tij me numër A.nr.613/2019 të datës 08.10.2019, duke udhëzuar të njëjtin për të drejtën hapjes së konfliktit administrativ në gjykatën kompetente.

Pas këtij njoftimi të Këshillit, ankuesi ka hapur konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, e cila me Aktgjykimin A.nr.3082/2019 të datës 16.04.2021, i pranuar në Këshill me datë 23.04.2021, ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke anuluar Njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 18.11.2019 dhe ka detyruar Këshillin të vendos për ankesën e ankuesit të datës 08.10.2019.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 4711/2019 të datës 08.10.2019 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesën e datës 23.09.2019; Kërkesën për përgjigje në Ankesë të datës 10.10.2019; Përgjigjen në Ankesë e datës 15.10.2019; Kërkesën për anulimin e konkursit e datës 08.10.2019; Emailin nga [] i datës 23.09.2019; Email nga [] i datës 23.09.2019; Intervistën me shkrim e datës 18.09.2019; Emailin nga [] e datës 17.09.2019; Formularin MAP-SHCK - 06 Njoftimi i Kandidatëve për Testimin nga Përzgjedhja e Ngushtë i datës 17.09.2019; Vendimin me numër protokolli 3693-3/19 për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për Emërimin e Anëtarëve të Komisionit Përzgjedhës në SHC i datës 17.09.2019; Emailin nga [] i datës 18.06.2019; Emailin nga [] datës 17.06.2019; Emailin nga [] i datës 12.06.2019; Emailin nga [] i datës 18.06.2019; Emailin nga [] i datës 17.06.2019; Formularin MAP -SHCK-06 Njoftimin i Kandidatëve për Testimin nga Përzgjedhja e Ngushtë i datës 17.09.2019; Raportin mbi Selektimin e Kandidatëve i datës 14.06.2019; Formularin MA-SHCK-05 Përcaktimi i Kriteve për Përfshirjen në Listën e Ngushtë i datës 14.06.2019; Vendimin për Emërimin e Anëtarëve të Komisionit Përzgjedhës në SHC i datës 12.06.2019; Formularin MAP - SHCK-04 Regjistri i Aplikacioneve të Pranuara; Formularin MAP-SHCK-04 Regjistri i Aplikacioneve të Pranuara; Konkursin për Avancim Titulli i Vendit të Punës Udhëheqës i Autoritetit Rajonal të Pellgjeve Lumore i datës 31.05.2019; Kërkesën për Punësim të datës 06.06.2019; Aplikacionin Formulari MAP- SHCK-03; Kërkesën për Punësim Formulari MAP - SHCK - 03; CV-në e [] Letërnjoftimin e Shiqeri Dërmaku; Ekstraktin nga Regjistri i datës 28.05.2018; Diplomë me numër nr.20 i datës 10.07.2014; Diplomën me numër nr. 6 ytë datës 24.12.1989; Shtojcën e Diplomës e datës 28.05.2018; Certifikatën e muajit Prill 2018; Certifikatën e datës 29.11.2002; Certifikatën e muajit Mars-Prill 2006; Certifikatën e muajit Mars-Prill 2006; Vërtetim i datës 19.09.2017; Urdhëresë e datës 29.06.1999; Fletëmërimin i datës 08.08.2000; Vërtetimin e datës 14.05.2003; Referencat e Preferuara i datës 31.08.2001; Aktvendimin e datës 15.09.1982; Raportet e Vlerësimit të Punës 2017-2018; Letër Rekomandimin e datës 27.05.2018; Letër Rekomandimin e datës 28.05.2018; Autorizimin e Publikimit të Konkursit i datës 28.05.2019; Kërkesën për fillimin e Rekrutimit Formulari MAP-SHCK-01; Vendimin A.nr.239/2012 i datës 05.05.2021 te KPMSHCK.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka vendosur që të përfundoj procedim administrativ i filluar me ankesën me numër A.nr.613/2019 të datës 08.10.2019 të parashtruar nga pasi që objekti i kësaj ankesë është bërë i pamundur, *sepse*:

Nga vlerësimi i provave të lëndës Kolegji ka gjetur se Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor bazuar në Autorizimin të datës 28.05.2019 të Departamentit të Administrimit të Shërbimit Civil/Ministrisë së Administratës Publike, më datë 31.05.2019, ka shpall konkurs për pozitën "Udhëheqës i Autoritetit Rajonal të Pellgjeve Lumore", në të cilin konkurs kanë aplikuar gjashtë (6) kandidatë, duke përfshirë edhe ankuesin. Në listën e shkurtër janë përfshirë 4 kandidatë dhe njëri nga aplikuesit për shkak të mos përfshirjes së tij në këtë listë, parashtron ankesë pas vendimit të KZAK-së Nr.08/2019 të ditës 08.07.2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me ç' rast Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor përmes e-mailit të datës 18.06.2019 të Udhëheqëses së Njësisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, ka bërë pezullimin e përkohshëm të kësaj procedure rekrutimi, e cila procedurë bazuar në shkresat e lëndës ka vazhduar me testin me shkrim dhe intervistën me gojë me vetëm një kandidatë gjegjësisht

i cili sipas Njoftimit të datës 27.09.2019 të Njësisë së Burimeve Njerëzore është përzgjedhur si kandidat i suksesshëm.

Ankuesi me datë 08.10.2019 në formë elektronike parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me pretendimin ankimor që organi i punësimit lidhur me procedurën e rekrutimit për pozitën "Udhëheqës i Autoritetit Rajonal të Pellgjeve Lumore" ka vepruar në kundërshtim me nenin 80 paragrafi 3 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil, pasi që i njëjti me datë 31.05.2016 ka parashtruar ankesë në KPMSHCK lidhur me pozitën e njëjtë sipas konkursit paraprak, e mbi këtë bazë propozon që Këshilli ta anuloj procedurën e kontestuar për pozitën e Udhëheqësit Rajonal të Pellgjeve Lumore.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave ka konstatuar së gjatë zhvillimit të procedurës së rekrutimit për pozitën e Udhëheqësit Rajonal të Pellgjeve Lumore pranë Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, e shpallur sipas konkursit të datës 31.05.2019, ka parashtruar ankesë me datë 08.08.2019 dhe kandidatja M. D, lidhur me shqyrtimin dhe vendosjen e të cilës Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil me Vendimin A.nr.239/2021 të datës 05.05.2021 ka anuluar procedurën e rekrutimit të kontestuar edhe nga ankuesi me ankesën e datës 10.08.2019. Andaj, si rrjedhojë Kolegji duke u bazuar në nenin 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative i cili parasheh se: *Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë*, ka konstatuar që të përfundoj procedimin administrativ i iniciuar me ankesën A.nr.613/2019 të datës 08.10.2019, pasi që objekti i ankesës është bërë i pamundur-kotë.

Bazuar në rrethanat si me lartë, Kolegji për shqyrtimin e ankesave bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numra A.nr.613/2019

Rushit Kajtazi

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj Demi

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit;
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së